

VENDIM
Nr. 17, datë 5.5.2017

MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË UK LUSHNJË QYTET SHA

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujrave të ndotura”, i ndryshuar dhe Metodologjisë “Për vendosjen e tarifave” Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë U K Lushnjë Qytet Sha :

a) Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizim me ujë	Largimi i ujrave të ndotura
Konsumator familjar	58 lekë/m ³	17 lekë/m ³
Konsumator publik	130 lekë/m ³	21 lekë/m ³
Konsumator privat	140 lekë/m ³	24 lekë/m ³

b) Tarifë fikse

Konsumator familjar 100 lekë/muaj/klient

Konsumator publik 200 lekë/muaj/klient

Konsumator privat 200 lekë/muaj/klient

c) Shitje uji me shumicë 32 lek/m³

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2017:

- uji pa të ardhura (humbjet) 72 %
- niveli i matjes 100 %
- kohëzgjatja e furnizimi 7 orë/ditë
- efienca e stafit 5.29 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 80 %
- mbulimi me kanalizime 50 %
- norma e arkëtimit 90 %
- cilësia e ujit (klor+koliform) sipas standarteve

3. Pagesa rregullatore vjetore për UK Lushnjë Qytet Sha do të jetë 0.6% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi KKRR nr. 6, datë 10.3.2014 “Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha U K Lushnjë qytet” shfuqizohet.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 1.6.2017 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Ndriçim Shani